



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr. 260, datë 16.09.2021

**PËR CAKTIMIN E ZNJ. DHORINA THEODHORI, NËPËRMJET PROCEDURËS
SË NGRITJES NË DETYRË, NË POZICIONIN E DREJTUESIT TË
PROKURORISË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË KORÇË**

Bazuar në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 47 pika 6 dhe 52 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenet 164 pika 8, 166 pika 2, 189 pika 1, germa “a” të Ligjit nr. 115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, i ndryshuar, në nenin 28 të Rregullores “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë në pozicionin e drejtuesit në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm”, me propozim të Komisionit për Zhvillimin e Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Të caktojë Znj. Dhorina Theodhori në detyrën e Drejtuesit të Prokurorisë, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë.
2. Znj. Dhorina Theodhori të ushtrojë funksionin e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë, nga data 16.09.2021 - 16.09.2024.
3. Të njoftohen për këtë vendim Znj. Dhorina Theodhori, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë dhe Prokurori i Përgjithshëm.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË



**KRYETAR
GENT IBRAHIMI**

**ANËTAR
KOSTAQ BELURI**

**ANËTAR
BUJAR SHESHI**

**ZV/KRYETAR
ALFRED BALLA**

**ANËTAR
NURIHAN SEITI**



ANËTAR
ELOIDA GOXHI

ANËTAR
VATË STAKA

ANËTAR
ESMERALDA KESHI

ANËTAR
SANDËR BECI

ANËTAR
MOISI DUDA

ANËTAR
TARTAR BAZAJ